



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

**K.P.P.558/2020**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.12.2020 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Kundërshtimi i vendimit të KVO lidhur me vlerësimin në pikë të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Sireta 2F” shpk në procedurën e prokurimit “*E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-65444-07-14-2020, me objekt Loti III “*Mirëmbajtje rutinë dhe dimerore me performancë rruga Korçe - Erseke + rruga unaza Erseke - Erseke + rruga K/Boboshtice – Dardhë*”, me fond limit 199,551,855.00 Lekë pa tvsh zhvilluar më datë 21.09.2020, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

**Ankimues:** “Sireta 2F” shpk  
Lagjia “Babrru-Fushë”, Njësia Administrative Paskuqan  
Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Autoriteti Rrugor Shqiptar  
“Rruga Sami Frashëri nr.33”, Tiranë

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të

Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”; Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”,

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 16.07.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-65444-07-14-2020, me objekt Loti III “Mirëmbajtje rutinë dhe dimerore me performancë rruga Korce - Erseke + rruga unaza Erseke - Erseke + rruga K/Boboshtice – Dardhë”, me fond limit 199,551,855.00 Lekë pa tvsh zhvilluar më datë 21.09.2020, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor depozituar pranë KPP më shkresën nr. 8253/1 datë 30.10.2020 si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se në datën 05.08.2020 autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së mësipërme të prokurimit (shprehja e interesit). Në këtë fazë kanë marrë pjesë operatoët si më poshtë.

- Sireta 2F shpk I kualifikuar
- 6D Plan I skualifikuar
- Niem I kualifikuar

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se pas mbylljes së fazës së parë dhe në përfundim të afateve të ankimit autoriteti kontraktor më datë 03.09.2020 me shkresën nr.4795/9 nëpërmjet sistemit elektronik ka drejtuar tek operatorët ekonomikë ftesën për ofertë. Data e përcaktuar për hapjen e ofertave është data 21.09.2020 ora 10:30. Operatorët që i janë përgjigjur ftesës për dorëzimin e ofertës ekonomike janë:

- Sireta 2F 144,444,444 lekë pa tvsh
- Niem&Avdolli 152,808,168 lekë pa tvsh

Në datën 21.09.2020 është zhvilluar faza e dorëzimit të ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës.

II.4. Në datën 01.10.2020 KVO-ja përfundoi vlerësimin në pikë të operatorëve ekonomikë si më poshtë:

1. OE Sireta 2F shpk

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	144,444,444	100	85	90	275
2	144,444,444	100	85	90	275

3	144,444,444	100	85	90	275
---	-------------	-----	----	----	-----

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 275 pikë.

Pikët e mësipërme në % duke kthyer në pikë janë si më poshtë”

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	144,444,444	60	17	18	95
2	144,444,444	60	17	18	95
3	144,444,444	60	17	18	95

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 95 pikë.

## 2. BOE “Niem” & Avdolli” shpk

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	152,808,168	95	100	100	295
2	152,808,168	95	100	100	295
3	152,808,168	95	100	100	295

Pikët e mësipërme në % duke kthyer në pikë janë si më poshtë”

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
------------------	------------------	-----------------------	--	--	------------

1	152,808,168	57	20	20	97
2	152,808,168	57	20	20	97
3	152,808,168	57	20	20	97

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mestare 97 pikë.

- Renditja përfundimtare e operatorëve ekonomikë do të jetë:

Nr.	Operatori ekonomik	Pikët mesatare në %	Pikët mesatare në pikë
1	Niem&Avdolli	295	97
2	Sireta 2F	275	95

II.5. Në datën 05.10.2020 operatori ekonomik “Sireta 2F” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, në mënyrë të përmbledhur me pretendimet si më poshtë:

- *Përzgjedhja e ofertës fituese me anë të ofertës ekonomike më të favorshme nga ana e autoritetit kontraktor duhet të përmbushë disa parakushte sine qua non për aplikimin e kësaj të fundit. Përmbushja e kushteve është esenciale për vetë qëllimet e ligjit të prokurimit publik mirëpërdorimin e fondëve publike. Për këtë qëllim ligjvënësi është treguar i kujdesshëm ku në nenin 55 të lex specialis LPP parashikon se oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kritere të ndryshme të lidhura me objektin e kontratës si cilësia, cmimi, cilësitë teknike, kataristikat estetike, funksionale, , mjedisore, kostot e funksionimit , efektshmëria ekonomike, .... me kusht që këto kritere të jenë objektive dhe jodiskriminuese. Neni 31 pika 2 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave parashikohet se : Kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme do të përdoret në kontrata komplekse dhe të një natyre të veçantë që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmbajnë dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit kontraktor shpenzime të tilla, si kostot e shërbimeve pas shitjes, pjesët e këmbimit, zgjidhjet më të favorshme teknike, mbështetjen teknike në të ardhmen apo ato që ndotin më pak mjedisin.*

*Sa më sipër përzgjedhja e ofertës ekonomike më të favorshme si kriter i përcaktimit të ofertës fituese ku cmimi ka peshën e 60% ndërsa përvoja në punë e kompanisë 20% dhe Cilësia 20% nuk është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Në përzgjedhjen e kritereve të vlerësimit të ofertave në procedurat e prokurimit publik nga ana juaj duhet ti qëndrojë strikt rregullimit ligjor*

*dhe duhet të përzgjedhi atë kriter i cili i përshtatet volumit, natyrës dhe kompleksitetit të procedurës së prokurimit të parashikuar për tu zhvilluar.*

*Sa më sipër në rastin konkret referuar natyrës së procedurës së prokurimit objekt ankimi llojit të shërbimit të kërkuar objekt i kontratës nuk përmban dhe elementë të tjera që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit kontraktor shpenzime të tilla si kostot e shërbimeve pas shitjes, pjesët e këmbimit, zgjidhjet më të favorshme teknike, mbështetjen teknike në të ardhmen apo ato që ndotin më pak mjedisin.*

- *Së dyti Arsyet që autoriteti kontraktor ka ngritur për skualifikimin e shoqërisë Sireta 2F shpk janë plotësisht të padrejta dhe diskriminuese pasi është lehtësisht e verifikueshme që shoqëria Sireta 2F shpk ka kapacitet të mjaftueshëm dhe madje i tejkalon cdo kriter të vënë në DT nga autoriteti juaj.*
- *Skualifikim tendencioz nuk është hera e parë që i bëhet shoqërisë sonë nga autoriteti juaj duke na diskriminuar dhe frenuar në mënyrë që ne të mos jemi të barabartë në konkurrim ashtu sic parashikohet në nenin 2 të LPP.*
- *Nga ana juaj nuk është bërë asnjë detajim në vlerësimin me pikë të kryer me qëllim që të ishte një panoramë transparente se përse subjekti ynë është renditur i dyti . Ne nuk e dimë as ofertën ekonomike të paraqitur nga BOE Niem&Avdolli shpk por ne jemi në gjendje që të dimë fare mirë dy elementët e tjerë në vlerësimin e ofertës sic janë cilësia dhe punët e ngjashme.*
- *Kështu nga ana jonë janë paraqitur 41 formularë të vlerësimit të punëve të kryera lëshuar nga autoritete të rëndësishme kontraktore që nga FSHZH , Bashkia e Tiranës etj që vërtetojnë faktin që të gjitha punët janë kryer me cilësinë e duhur kriter ky që referuar dokumentave të tenderit vlerësohet deri në 20 pikë. Me logjikën më të thjeshtë duhet bashkimi tjetër i operatorëve ekonomikë Niem &Avdolli shpk të ketë paraqitur më shumë vërtetime ose formularë vlerësimi nëse ai ka marrë më shumë pikë se ne dhe në këtë rast.*
- *Në lidhje me treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementët e saj si psh por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura , personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i sisit, siguria , sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të punimeve dhe cdo aktivitet tjetër sic mund të përcaktohet nga punëdhënësi, nga ana jonë janë paraqitur të gjithë elementët e sipërcituar duke përmbushur kriterin e dhënë nga ana juaj. Duke njohur kapacitetet e BO tjetër konkurrues jemi të bindur që edhe në këtë rast grumbullojmë më shumë pikë.*
- *E lënë në fund por jo më pak e rëndësishme oferta jonë ekonomike 144,444,444 lekë pa tvsh ose 55,107,411 lekë më pak se fondi limit jemi të sigurt që është cmimi më i ulët i ofruar prandaj dhe këtu duhet të grumbullonim të gjitha pikët e mundshme prej 60 pikësh.*
- *Atherë si mundet që ne të renditemi në vendin e dytë dhe të tentohet të shpallet fitues ofertuesi që nuk përmbush kriteret krahasueshëmrisht me ne??*
- *Për sa më sipër kërkojmë bazuar në parimet bazë të prokurimit publik , rivlerësimin e ofertës së paraqitur nga ana jonë si oferta më e favorshme me vlerë më të ulët duke bërë riklasifikimin përkatës.*

II.6. Në datën 09.10.2020 nëpërmjet shkresës me nr.7376/2 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke vendosur mospranimin e ankesës.

II.7. Në datën 19.10.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor. Gjithashtu në ankesën drejtuar KPP ankimuesi ka pretenduar si vijon: *BOE Niem &Avdolli shpk nuk kanë të rregjistruar ansjë makineri në rregjistrat tregëtar për të dhënat e subjekteve ndërkohë subjekti Sireta 2F shpk i ka të rregjistruara të gjitha makineritë të deklaruara në tender. Regjistrimi i mkinerive është detyrim ligjor.*

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 8253/1 prot., datë 30.10.2020, protokolluar me tonën me shkresën nr.1308/2 datë 04.11.2020 me objekt “*Dërgim informacioni*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik Sireta 2F shpk mbi kundërshtimin e vendimit të KVO lidhur me vlerësimin e tij në pikë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 3, pika 18 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Procedurë e kufizuar” është procedura, përmes së cilës çdo operator ekonomik mund të kërkojë të marrë pjesë, por vetëm operatorët ekonomikë të përzgjedhur nga autoriteti kontraktor mund të dorëzojnë oferta.*

III.1.2. Në nenin 31 “Kriteret për Vlerësimin e Ofertës”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *Kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme do të përdoret në kontrata komplekse dhe të një natyre të veçantë që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmbajnë dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit kontraktor shpenzime të tilla, si kostot e shërbimeve pas shitjes, pjesët e këmbimit, zgjidhjet më të favorshme teknike, mbështetjen teknike në të ardhmen apo ato që ndotin më pak mjedisin.*

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehesh në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë.

Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet standarde të tenderit.

III.1.3. Në dokumentat e tenderit, kreu II “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni 4, “Kriteret e vlerësimit”, janë përcaktuar kriteret e vlerësimit si më poshtë:

*Kjo procedurë përfshin dy faza kryesore*

**Faza 1 – Parakualifikimi:** Kandidatët do të dorëzojnë dokumentat e kërkuara në DT. Autoriteti Kontraktor do të shqyrtojë dokumentat e dorëzuara nga Kandidatët dhe do të vlerësojë nëse ky dokumentacion plotëson kërkesat e kualifikimit të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

**Faza 2 - Ftesa për Ofertë:** Autoriteti Kontraktor do të dërgojë një ftesë për ofertë tek Kandidatët, të cilët, kanë plotësuar kërkesat për parakualifikim duke i ftuar të dorëzojnë një ofertë teknike dhe ekonomike. Ofertat do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Autoriteti Kontraktor për të përcaktuar ofertën fituese.

#### **4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

A) **çmimi më i ulët**

*Ose*

B)  **oferta ekonomikisht më e favorshme**

*lidhur me rëndësinë: Çmimi*  **pikë**

*etj.*  **pikë**

#### **Kriteret e Vlerësimit**

**Pikët**

(i) **Çmimi më i ulët**

**[0-60]**

*Operatori ekonomik duhet të përshkruajë ofertën.*

(ii) **Pervoja ne pune e kompanise**

**[0-20]**

*Operatori ekonomik duhet të përshkruajë punet e relalizuar ne forme CV, shoqeruar me vertetim punimesh, te kryera ne 10 viteve te fundit.*



*Treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të punimeve dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi.*

*Autoriteti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për çdo kriter vlerësimi të vendosur.*

III.1.4. Referuar bazës ligjore të sipërcituar ku parashikohet se faza e dytë e procedurës së prokurimit objekt ankimi në tërësi i nënshtrohet vlerësimi të tre elementëve kryesorë, të tillë si oferta ekonomike më e favorshme, Pervoja ne pune e kompanise dhe cilësia e cila përfshin treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të punimeve dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi.

Komisioni i Prokurimit Publik në analize të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik Sireta 2F në fazën e dytë të procedurës së prokurimit objekt ankimi, konstaton se në lidhje me komponentin e parë oferta ekonomike më e favorshme ka parqitur formularin e ofertës në vlerën 144,444,444 lekë pa tvsh. Ndërsa në lidhje me komponentin e dytë Pervoja ne pune e kompanisë- Operatori ekonomik duhet të përshkruajë punet e realizuar ne forme CV, shoqeruar me vertetim punimesh, te kryera ne 10 viteve te fundit, Sireta 2F ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë :

- CV e Kompanisë në të cilën përshkruan eksperiencat lidhur me përvojën e ngjashme si vijon:
- Kontrata me vlerë 19,370,727 me objekt Ndërtim Kanalizime Ujërave të zeza Komuna Paskuqan 1 Babrru Kodër.Viti 2009
- Kontrata me vlerë 78,290,806 me objekt Sistemim Asfaltim , Kanalizim dh Ndricim Rrugor në Rrugën Babrru Fushë Kërcik , Babrru Kodër-Babru Qendër. Viti 2009.
- Kontrata me vlerë 5,599,999 me objekt Kanalizimi i Ujrave të Zeza Paskuqan. Viti 2009.
- Kontrata e me vlerë 12,222,222 me objekt Rikonstuksion Rruge Gryke, Bashkina Kavajë. Viti 2009.
- Kontrata me vlerë 8,888,888 me objekt Rikosntruksion i Rrugës Rinas Aeroport. Viti 2009.

- Kontratë me vlerë 2,555,555 me objekt Rikonstruksion i Arshivës së Ministrisë së Shëndetësisë .Viti 2009.
- Kontratë me vlerë 7,562,300 me objekt “Rikonstruksion i rrugës te Xhamia, Komuna Golem. Viti 2009.
- Kontratë me vlerë 18,369,688 me objekt Ndërtim KUZ nga shkolla 9 vjecare Mëzes Fushë Coca Cola. Viti 2010.
- Kontratë me vlerë 5,499,730 me objekt Rikonstruksioni i Segmentit të Rrugës Mihal Duri, Fshati Katund i Ri Kashar. Viti 2010.
- Kontratë me vlerë 25,728,932 me objekt Asfaltim i rrugës nga autostrada deri në qendër Gramëz. Viti 2010.
- Kontratë me vlerë 5,798,400 me objekt Blerje Bordura provizore varri. Viti 2010.
- Kontratë me vlerë 12,285,568 me objekt Rikonstruksion dhe Asfaltim i rrugës së varezave Vorë dhe segmenti i rrugës Ambulanca e Vjetër ish Reparti Ushtarak.Viti 2010.
- Kontrata me Vlerë 4,972,270 me objekt Ndricim rrugor pjesor i qytetit faza e I-rë. Viti 2011.
- Kontrata me vlerë 12,373,578 me objekt Sistemim Asfaltim rruga Arranerasit Kishë Gabinë. Viti 2011.
- Kontratë me vlerë 33,747,660 me objekt Ndërtim rruga Lunxheria Kamëz. Viti 2011.
- Kontratë me vlerë 11,300,470 me objekt Ndërtim mbikalimi me konstruksion metalik në rrugën nacionale Kamëz. Viti 2011.
- Kontratë me vlerë 50,917,618 me objekt Ndërtim rrjeti shpërndarës ujësjellësi fshati Yrshek. Viti 2011.
- Kontratë me vlerë 8,841,064 me objekt Restaurimi i sallës së leksioneve dhe aneksesve të saj si dhe kati i dytë i godinës së laboratorit të kimisë. Viti 2011.
- Kontratë me vlerë 11,066,666 me objekt Sistemim asfaltim i rrugës ambulanca e vjetër ish reparti ushtarak dhe rruga e varrezave vorë. Viti 2012.
- Kontratë me vlerë 17,866,666 me objekt Ndërtim Kuz tek rruga Drini Zana Lagje nr.1,2,3,4 Bathore 2012. Viti 2012.
- Kontratë me vlerë 12,266,666 me objekt Ndërtimi i linjës kryesore të Kuz Lagjia nr.2. Viti 2012.
- Kontratë me vlerë 52,000,000 me objekt Rikonstruksion i rrugës Lllazar Shapatini. Viti 2012.
- Kontratë me vlerë 12,933,332 me objekt Rikonstruksion i catisë së shkollës së mesme teknike ekonomike. Viti 2012.

- Kontratë me vlerë 3,613,273 me objekt Sistemim dhe ndërtim i sistem vaditjes në EDE. Viti 2012.
- Kontratë me vlerë 15,430,617 me objekt Rikonstruksion i vendburimeve Shën Mëri dhe rrethimi i saj. Viti 2012.
- Kontratë me vlerë 5,879,851 me objekt Ndërtim rruga Coca Cola Laknas. Viti 2013.
- Kontratë me vlerë 5,511,355 me objekt Ndërtim rruga Klosi Bathore 1. Viti 2013.
- Kontratë me vlerë 13,831,301 me objekt Ndërtim rruga Kongresi i Lushnjës Bathore7. Viti 2013.
- Kontrata me vlerë 7,242,072 me objekt Ndërtim Kuz rruga Gjirokastër Nyja Valiasi i ri. Viti 2013.
- Kontratë me vlerë 14,050,156 me objekt Ndërtim rruga Kozarë. Viti 2013.
- Kontratë me vlerë 7,922,620 me objekt Ndërtim rruga Nazmi Kryeziu+Selanik Kamëz. Viti 2013.
- Kontratë me vlerë 10,760,689 me objekt ndërtim rruga Rilindja Kamëz. Viti 2013.
- Kontratë me vlerë 54,116,738 me objekt Rikonstruksion i segmentit rrugor Poloskë përparimaj Loti II. Viti 2013.
- Kontratë me vlerë 28,963,561 me objekt Ndërtim Kuz Dias Gurrë e Vogël. Viti 2013.
- Kontratë me vlerë 30,666,666 me objekt Ndërtim i linjës së ujësjellësit nga depo Kinostudio deri kryqëzimi i rrugëve Aleksandër Moisiu dhe Xhanfize Keko. Viti 2013.
- Kontratë me vlerë 420,000 me objekt Shitje materiale ndërtimi. Viti 2014.
- Kontratë me vlerë 1,959,977 me objekt shitje materiale ndërtimi. Viti 2014.
- Kontratë me vlerë 252,000 me objekt Punime në pastrimin e kanalizimeve në UBT. Viti 2014.
- Kontratë me vlerë 346,665 me objekt shitje materiale ndërtimi Tuba betoni. Viti 2014.
- Kontratë me vlerë 276,000 me objekt materiale ndërtimi për nevojat e shërbimeve funerale. Viti 2014.
- Kontratë me vlerë 180,000 me objekt Mirëmbajtje e ambjenteve të jashtme të oborrit gjelbërimi i pemëve dekorative. Viti 2014.
- Kontratë me vlerë 144,000 me objekt materiale ndërtimi. Viti 2014.
- Kontratë me vlerë 2,299,610 me objekt Rrethi i Varezave.
- Kontratë me vlerë 9,066,666 me objekt Ndërtim Rruga 28 Nëntori.
- Kontratë me vlerë 3,989,400 me objekt Blerje inerte.

- Kontratë me vlerë 13,333.380 me objekt Argjinatura mbrojtëse nga lumi shkumbin në çërrik. Viti 2014.
- Kontratë me vlerë 2,397,708 me objekt Materiale për pastrim dezinfektim dhe ndricim. Viti 2015.
- Kontratë me vlerë 65,915 me objekt Sistem trotuari dhe ujëra të zeza ekonomiku vjetër. Viti 2015.
- Kontratë me vlerë 30,013 me objekt Punime sistemim tereni pranë godinës së pyjores. Viti 2015.
- Kontratë me vlerë 55,195 me objekt Riparim i ventilatorëve tre fazor 700ë pastrim, avëllzhim, ndricim dhe guzhineta. Viti 2015.
- Kontratë me vlerë 2,651,122 me objekt Restaurim i sallës së kuajve. Viti 2015.
- Kontratë me vlerë 8,670,309 me objekt Rikonstruksion i objekteve ndërtimore në UBT. Viti 2015.
- Kontratë me vlerë 16,435,583 me objekt Rikonstruksion i cerdhes Shkozë. Viti 2015.
- Kontratë me vlerë 99,900 me objekt Rikonstruksion i qendrës shëndetësore shkozë. Viti 2015.
- Kontratë me vlerë 3,065,753 me objekt Vizatimet e rrugëve kamëz 2015. Viti 2015.
- Kontratë me vlerë 9,626,316 me objekt Sistemim asfaltim i rrugës së toptanëve . Viti 2015.
- Kontratë me vlerë 15,819,742 me objekt Sistemim Asfaltim i Rrugës Allcaushaj. Viti 2015.
- Kontratë me vlerë 10,620,618 me objekt Sistemim Asfaltim i Rrugës Xhirajve. Viti 2015.
- Kontratë me vlerë 500,040 me objekt Rikonstruksion i fasadës së pallatit. Viti 2015.
- Kontratë me vlerë 420,000 me objekt Sistemim i lulishtes pranë Ministrisë. Viti 2015.
- Kontratë me vlerë 2,692,800 me objekt blerje materiale ndërtimi. Viti 2015.
- Kontratë me vlerë 4,287,600 me objekt Blerje materiale ndërtimi . Viti 2015.
- Kontratë me vlerë 11,220,757 me objekt Rikonstruksion rruga Migjeni fshati Yzberisht Komuna Kashar. Viti 2015.
- Kontratë me vlerë 14,666,666 me objekt Sistem Asfaltim Rrugë Allmete Durice Alle. Viti 2015.
- Kontratë me vlerë 27,466,667 me objekt Mirëmbajtje bazuar në performancë në segmentin rrugor Mbikalimi Kamëz..... Viti 2016
- Kontratë me vlerë 44,653,947 me objekt Mirëmbajtje bazuar në performancë në segmentin rrugor Tiranë Ndroq Romanat.....Viti 2016.

- Kontratë me vlerë 7,894,719 me objekt Pastrim me eskavator i kanaleve kulluese ujtëse. Viti 2016.
- Kontratë me vlerë 11,712,960 me objekt Sistemim Asfaltim Rruga Gramëz . Viti 2016.
- Kontratë me vlerë 81,333,332 me objekt Rikonstruksion rruga Vrinë Fshati Rinia. Viti 2016.
- Kontratë me vlerë 3,199,999 me objekt Riparime sheshesh Ura Fushë Kërcik+Rruga pranë shkollës.
- Kontratë me vlerë 666,518 me objekt Ndërtim Kuz Fier Kamëz 3. Viti 2016.
- Kontratë me vlerë 9,576,263 me objekt ndërtim Kun Paskuqan 1 Rruga Ibrahim Rugova. Viti 2016.
- Kontratë me vlerë 61,746,373 me objekt Rehabilitim Blv demokracia. Viti 2016.
- Kontratë me vlerë 125,599,296 me objekt Sistemim Asfaltim i rrugës Petrushë Vreshtas.Viti 2016.
- Kontratë me vlerë 12,000,000 me objekt Rikonstruksion i kopshtit nr.55 Kinostudio. Viti 2017.
- Kontratë me vlerë 8,871,290 me objekt Rikonstruksion Rruge të brendshme Fshatit Zall Herr. Viti 2017.
- Kontratë me vlerë 226,533,199 me objekt Ndërtim Rruga Unaza e Re Peshkopi. Viti 2017.
- Kontratë me vlerë 28,504,320 me objekt Ndërtim Rruga Rilindja Bashkia Kamëz. Viti 2017.
- Kontratë me vlerë 34,133,010 me objekt Blerje inerte. Viti 2017.
- Kontratë me vlerë 62,200,000 me objekt Rikonstruksion rruge Babrru Kodër e Kuqe Bovill. Viti 2017.
- Kontratë me vlerë 79,999,999 me objekt Sistemim rrugësh blloku tek stadiumi. Viti 2017.
- Kontratë me vlerë 1,928,400 me objekt Rikonstruksion i urës në fshatin Vrinë

78	Bashkia Kamëz	Ndërtim rruga Rilindja, Bashkia Kamëz	2017	28,504,320
79	Drejtoria e Punëtorëve Nr.2.	Blerje inerte.	2017	34,133,010
80	Bashkia Kamëz	Rikonstruksion rruge Babrru Kodër e Kuqe Bovill.	2017	62,200,000
81	Bashkia Pogradec	Sistemit rrugësh blloku tek Stadiumi	2017	79,999,999
82	Beqiri Shpk	Rikonstruksion i urës në fshatin Vrinë në Bashkinë Durrës.	2017	1,928,400
83	Bashkia Tiranë	Rikonstruksion i infrastrukturës rrugore të bllokut që kufizohet nga rruga Besa-Siri Kodra-Zenel Bastari-Haki Rexhep Kodra (përfshir dhe rrugën të Nish Kimike).	2017	160,000,000
84	Kontakt Shpk	Asfaltim i pjesës para pallatit.	2018	156,000
85	Kurt Kola	Rikonstruksion fasade.	2018	150,000
86	Drejtoria e Punëtorëve Nr.2	Blerje inerte.	2018	56,540,880
87	Ergi Shpk	Ndërtim ndërtese 2 dhe 3 katëshe.	2018	380,800
88	Ministria e Shëndetësisë	Loti 4 "Rikonstruksion i disa QSH- re në qarqet Gjirokastrë, Vlorë dhe Fier"	2018	62,222,222
89	Bashkia Vorë	Rikualifikim Urban i hapsirave publike dhe restaurim fasadash të pallateve të qytetit Vorë, Bashkia Vorë.	2018	32,400,000
90	Bashkia Vorë	Sistemit-Asfaltim i Rrugëve të Brendshme Lagje e Re, Loti 4, Aksi-07, Prog.0+000/0+201, Aksi -08 Prog.0+000/0+068"	2018	21,600,000
91	Ujësllës Kanalizime Tiranë	Ndërtim rrjeti shpërndarës ujësllës dhe ndërtim Depo në zonën e Shkozës së Sipërme, Njësia Administrative 1.	2018	19,999,999
92	Ujësllës Kanalizime Tiranë	Ndërtim impianti klorinimi dhe rikonstruksion depon në Qytetin e Tiranës.	2018	33,600,000
93	Bashkia Kamëz	Rruga "Roma,Londer,Valeta" Kamëz 1.	2018	21,565,650

94	Bashkia Cerrik	Stacioni i Autobuzeve dhe sinjalistike	2018	9,360,000
95	Bashkia Kamez	"NdërtimRRUGA "Mustafa Lita"	2019	47,999,999
96	Bashkia Kamez	Rikonstruksion i rrugëve blloku Frutikultur+Kamez	2019	41,333,316
97	Bashkia Pogradec	Linja e jashteme e Ujesjellesit Uji i Zi-Dalja e Tunelit",Bishnic,Njesia Administrative Velcan	2019	11,999,999
98	BAMI SHPK	Ndërtim i rruges Fshati Cerkeze-Zgafrore,Njesia Administrative Zall -Herr(Faza II)	2019	8,548,380
99	BASHKIA TIRANE	Rikonstruksion i rruges Zall-Bastarit(Ura Zall Dajt deri ne Zall Bastare)-Loti 1.1	2019	66,666,666
100	MINISTRIA E SHENDETESISE	Loti2-Rikonstruksion i disa QSH ne qarqet Berat Korce dhe Elbasan	2019	83,968,247
101	BASHKIA VORE	Ndërtim i kanalit b/a dhe ndricim ne rrugen Miqesia Domje,Njesia Administrative Berxhull	2019	33,066,666
102	AUTORITETI RRUGOR SHQIPETAR	Rikonstruksion i Ures se Dragotit	2019	11,066,666
103	BASHKIA KAMEZ	Ndërtim rruga Skenderbeu+Shebeniku	2019	64,799,999
104	BASHKIA TIRANE	Ndërtim i godines se zjarrefikses	2020	47,777,777
105	FSHZH	Rehabilitim i sheshit " Ahmet Zogu" dhe parku "Geraldin" ne Qytetin e Burrelit"	2020	81,995,666
106	BASHKIA KAMEZ	Rindërtim i objekteve arsimore:"Kopeshti Niko Hoxha,Kamez"	2020	88,888,888

- Formular Vlerësimi lëshuar nga ARSH për OE Sireta 2F shpk për kontratën me objekt Mirëbajtje bazuar në performancën në segmentet rrugore Tiranë Ndroq Romanat ... me vlerë të realizuar të kontratës 38,102,605 lekë me tvsh. Perfunduar Viti 2018.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Krujë për kontratën me objekt Sistemim adfaltim rruga Gramëz lagjia bregu i lumit, Thumanë, me vlerë të realizuar të kontratës 11,341,440 lekë pa tvsh. Perfunduar 22.11.2016
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Bulqizë për kontratën me objekt Sistemim Asfaltim Rruga Allmete Durice Alle me vlerë të realizuar 14,638,862 lekë me tvsh.30.11.2015. 26.10.2016.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Durrës për kontratën me objekt Rikonstruksion rruga Vrrin Fshati Rinia me vlerë të realizuar të kontratës 81,328,990 lekë. 31.01.2017
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Kamëz për kontratën me objekt ndërtim Kun paskuqan 1 dhe Rruga Ibrahim Rrugova me vlerë të realizuar 7,997,363 lekë me tvsh. 31.01.202017.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Kamëz për kontratën me objekt Ndërtim Rr Roma +Rr Londer+Rr Valeta Kamëz”, me vlerë të realizuar 21,564,570 lekë me tvsh. 21.02.2019
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Kamëz për kontratën me objekt Rikonstruksion i rrugëve Babrru Kodër e Kuqe Konferenca e Bujanit Ndoc Gjetja Impinati i shkarkimit të bovillës, me vlerë të realizuar 61,192,440 lekë me tvsh. 18.02.2019.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Kamëz për kontratën me objekt ndërtim i rrugës Mustafa Lita me vlerë të realizuar 47,999,682 lekë me tvsh. **28.06.2019**
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Kamëz për kontratën me objekt Ndërtim Rruga Rilindja Kamëz, me vlerë të realizuar 23,,753,600 lekë pa tvsh. 24.08.2017.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Kamëz për kontratën me objekt Ndërtim rruga Demokracia me vlerë të realizuar 51,541,213 lekë me tvsh. 19.07.2017
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Kamëz me objekt Ndërtim rruga Lunxheria Laknas me vlerë të realizuar 28,121,960 lekë pa tvsh. 23.06.2014.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Maliq për kontratën me objekt Rikonstruksion sistemim asfaltim i rrugës petrushë Vreshtas me vlerë të realizuar 105,568,320. 10.10.2017.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Pogradec për kontratën me objekt Linja e jashtme e Ujësjellësit Uji i Zi me vlerë të realizuar 11,999,999. 19.07.2019
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Pogradec për kontratën me objekt Sistemim rrugësh Blloku tek stadiumi me vlerë të realizuar 79,998,545 lekë me tvsh. 03.10.2018.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Tiranë për objektin e kontratës Rikonstruksion i infrastrukturës rrugore të bllokut që kufizohet nga rruga besa Siri Kodra me vlerë të realizuar të kontratës 159,993,129 lekë me tvsh.

- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Tiranë për objektin e kontratës Rikonstruksion Rrugë të brendshme Fshati Zall Her me vlerë të realizuar të kontratës 7,559,970.48 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Vorë për objektin e kontratës Sistemim asfaltim rruga Allcaushaj në fshatin merikaj Bahkia Vorë me vlerë të realizuar 15,817,762 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Vorë për objektin e kontratës Rikualifikim Urban i hapsirave publike dhe restaurim fasadash të pallateve në Marikaj Bashkia Vorë me vlerë të realizuar 32,132,315 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Vorë për objektin e kontratës Sistemim Asfaltim Rrugë Kodra e Xhirajve Fshati Marqinet me vlerë të realizuar 10,609,846 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Vorë për objektin e kontratës Sistemim Asfaltim Rrugë e Toptanëve në Fshatin Mariakj Bashkia Vorë me vlerë të realizuar të kontratës 9,620,338 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bordi i Kullimit Elbasan për objektin e kontratës Argjinatura mbrojtëse nga lumi Shkumbin në Cerrik, me vlerë të realizuar 13,333,380 lekë.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Elbasan për objektin e kontratës Ndërtim i rrugës së re nga kryqëzimi i rrugës 28 Nëntori deri në kryqëzimin e rrugës Rinia” me vlerë të realizuar 9,066,662 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Kamëz për objektin e kontratës Ndërtim rruga Kozarë Laknas Bashkia Kamëz me vlerë të realizuar 14,046,642 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Kamëz për objektin e kontratës Ndërtim rruga Rilindja Kamëz me vlerë të realizuar 9,032,228 lekë me tvsh . Vlera e realizuar sipas kontratës shtesë 1,728,461 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Kamëz për objektin e kontratës Ndërtim rruga Nazmi Kryeziu Selaniku Kalifornia Lagjia 4 Kamëz me vlerë të realizuar 7,906,699 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Tiranë për objektin e kontratës Rikonstruksion Cerdhe Shkozë me vlerë të realizuar 15,693,812 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Tiranë për objektin e kontratës Rikonstruksion i rrugës Llazar Shapatani me vlerë të realizuar 51,975,780 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar për objektin e kontratës Mirëmbajtje bazuar në performancë në segmentet rrugore Mbikalimi Kamëz Kryq me vlerë të realizuar 20,378,818 lekë me tvsh.
- Vërtetim realizim kontrate nr.1429/1 prot datë 18.05.2018 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme Nr.2 e Punëtorëve të Qytetit për objektin e kontratës Blerje inerte me vlerë totale 34,133,010 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga FSHZH për objektin e kontratës Ndërtim i rrugës Unaza e Re Peshkopi, me vlerë të realizuar 226,497,949 lekë me tvsh.



- Formular Vlerësimi lëshuar nga Komuna Petrelë për objektin e kontratës ndërtimi i kanalizimeve të ujrave të zeza të fshatit Gurrë e Vogël dhe Gurrë e Re Daias me vlerë të realizuar 25,449,927 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Këshilli i Qarkut Korçë për objektin e kontratës Rikonstruksion i segmentit rrugot Poloskë Përparimaj Loti II me vlerë të realizuar 45,333,333 lekë me tvsh. Vlera e realizuar sipas kontratës shtesë 8,783,406 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për objektin e kontratës Rikonstruksion i disa qendrave shëndetësore në qarqet Gjirokastër, Vlorë dhe Fier Loti 4 me vlerë të realizuar 62,222,215.5 lekë me tvsh .
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe mbrojtjes Sociale për objektin e kontratës Rikonstruksion i disa QSH në qarqet Berat Korçë dhe Elbasan me vlerë të realizuar 89,967,488 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Ndërmarrja e Rrugëve Rurale Qarku Tiranë për objektin e kontratës Blerje material inert cakëll me vlerë të realizuar 2,692,800 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Tiranë për objektin e kontratës Rikonstruksion i Kopshtit Nr.55 me vlerë të realizuar 11,995,587 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Universiteti Bujqësor i Tiranës për objektin e kontratës materiale për pastrim dezinfektim ngrohje dhe ndricim me vlerë 2,397,708 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Ujësjellës Kanalizime Tiranë për objektin e kontratës Ndërtim Linje Ujësjellësi nga Depo Kinostudio deri tek Kryqëzimi i Rrugëve Aleksandër Mojsiu dhe Xhanfize Keko me vlerë të realizuar 30,66,489 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Ujësjellës Kanalizime Tiranë për objektin e kontratës ndërtim impianti klorinimi dhe rikonstruksion deponesh në Qytetin e Tiranës me vlerë të realizuar 33,220,410.12 lekë me tvsh.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Ujësjellës Kanalizime Tiranë për objektin e kontratës Ndërtim rrjet ujësjellësi në shknozën e sipërme dhe ndërtim depo uji” me vlerë të realizuar 19,997,416 lekë me tvsh.

III.1.5. KPP vlen të sqarojë se ka një dallim të qartë midis kritereve të vecanta për kualifikim në drejtim të dëshmisë së eksperiencës së ngjashme gjatë tre viteve të fundit të hartuar në përputhje me nenin 46 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenin 28 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, dhe kriterit të përcaktimit të ofertës fituese. Në rastin konkret, KPP gjen me vënd të sqarojë se nga ana e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në fazën e parë të procedurës së prokurimit, janë vlerësuar nga ana e autoritetit kontraktor se disponojnë eksperiencë të ngjashme, për rrjedhojë vlerësimi i kapacitetit teknik me pikë në fazën e dytë do të mbështet në një vlerësim të qëndrueshmërisë së eksperiencës teknike në 10 vitet e fundit në kontrata të ngjashme, dëshmisë së operatorët ekonomikë disponojnë eksperiencë dhe aftësi teknike për realizimin me sukses të kontratës, parë kjo gjithashtu edhe në rrafsh krahasimor me operatorin tjetër ekonomik.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se referuar objektit të prokurimit operatori ekonomik “Sireta 2F” shpk nuk shfaq një eksperiencë shumë të gjatë dhe të thelluar në fushën e mirëmbajtjes së segmenteve rrugore në përputhje me objektin e prokurimit. Me dokumentacionin e paraqitur ky operator dëshmon se ka realizuar më së shumti kontrata me objekt rikonstruksion të objekteve civile, por shumë pak në fushën e infrastrukturës rrugore sic mund të jenë kontrata me objekt ndërtim rrugësh të cilat konsiderohen të ngjashme me natyrën e kontratës objekt ankimi. KPP vëren se nga tërësia e eksperiencave të paraqitura operatori ekonomik Sireta shpk dëshmon se ka një eksperiencë fare të vogël në fushën e mirëmbajtjes.

Komisioni gjykon se procesi i pikëzimit në rastin konkret është bërë në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesi. Fryma e LPP është e tillë që çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit. Në rastin konkret kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor për “Përvoja për punë të ngjashme” në fushën e mirëmbajtjes së segmenteve rrugore nuk është plotësuar në maksimumin e mundshëm nga operatori ekonomik Sireta 2F shpk e rrjedhimisht pretendimi i tij për një pikëzim maksimal lidhur me këtë komponent nuk është i justifikuar.

Ndërkohë parë në rafsh krahasimor dokumentacioni i ofertuesit BOE Avdolli&Niem shpk KPP vëren se ky i fundit në funksion të komponentit lidhur me eksperiencën e ngjashme ka paraqitur si vijon:

- Formular Vlerësimi lëshuar nga ARSH për OE Avduli shpk për kontratën me objekt Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë aksi rrugor Zemblak –K/Liqenas 17.0 km me vlerë të realizuar 19,945,800 lekë me tvsh.
- Vërtetim lëshuar nga ARSH Drejtoria e Rajonit Jugor për BOE Niem shpk &Alb Korca 2002 shpk për objektin e kontratës Mirëmbajtje rutinë e dimërore me performancë aksi rrugor Korcë Ersekë 42 km me vlerë 37,098,237 lekë me tvsh. Niem 70%.
- Formualar Vlerësimi lëshuar nga ARSH për BOE Niem &Vashtëmia shpk për kontratën me objekt Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë aksi rrugor Bilisht Baban Hocisht 10.2 km me vlerë te realizuar 8,476,176 lekë me tvsh. Niem shpk 85%.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Devoll për OE Niem shpk për objektin e kontratës Mirëmbajtje dhe pastrim nga dëborat e rrugëve rurale, me vlerë të realizuar 8,400,000 lekë
- Vërtetim nr.398 prot datë 18.06.2018 lëshuar nga DRJ për BOE Avdolli& Vashtëmia shpk për kontratën me objekt Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga K/Boboshticë-Dardhë+rruga Korcë- Voskopojë 35 km”, me vlerë të realizuar 33,755,990 lekë me tvsh. Avdolli shpk 82 %.

III.1.6. Sa më sipër KPP gjykon se KVO pranë autoritetit kontraktor me të drejtë ka vlerësuar eksperiencën e ngjashme të ofertuesit Niem shpk &Avdolli shpk me pikët maksimale dhe më tepër se operatori ekonomik “Sireta 2F” shpk pasi dokumentacioni i paraqitur nga BOE dëshmon qartë eksperiencë më të madhe në fushën e mirëmbajtjes së akseve rrugore e duke

dëshmuar eksperiencë jo vetëm të ngjashme por tërësisht të njëjtë me objektin e prokurimit, rrjedhimisht edhe vlerësimi lidhur me këtë ofertues duhet të jetë më i lartë.

Komisioni gjykon se procesi i pikëzimit nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, është bërë në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesi. Fryma e LPP është e tillë që çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit. Në rastin konkret kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor për “Përvoja për punë të ngjashme” në fushën e mirëmbajtjes së segmenteve rrugore është plotësuar më mirë nga BOE Niemi shpk&Avdoli shpk e rrjedhimisht pikëzimi maksimal lidhur me këtë komponent është i justifikuar.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.2.Në lidhje me metodologjinë e propozuar, KPP vëren se operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë dorëzuar një kapitull të veçantë të propozimit teknik në të cilin japin përshkrimin e përjasjes teknike, metodologjisë, planit të punës si edhe aftësisë organizative të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

Sa i takon pretendimit të operatorit ekonomik ankimues Sireta 2F shpk se *Duke njohur kapacitetet e BOE tjetër konkurrues jemi të bindur që edhe në këtë rast grumbullojmë më shumë pikë*”, KPP Referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor ka përzgjedhur procedurën e “Kufizuar” në përputhje me nenin 31 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, si edhe ka përcaktuar si kriter të përcaktimit të ofertës fituese, ofertën ekonomike më të favorshme në kuptim të nenit 55 pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar. Kështu, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor në përcaktimin e ofertës fituese ka përzgjedhur tre komponentë, cmimi më i ulët i cili referuar dokumentave të procedurës së prokurimit zë 60 % të peshës së vlerësimit, (ii) Përvoja në punë e kompanisë e cila zë 20 % të peshës së vlerësimit dhe cilësia e cila zë gjithashtu 20 % të peshës së vlerësimit. Në respekt të nenit 31 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet standarde të tenderit.

Komisioni i Prokurimit Publik nënvizon se është në të drejtën e autoritetit kontraktor në cilësinë e autoritetit përgjegjës për prokurimin e fondeve publike në kuptim të nenit 12 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar që të përzgjedhë në përputhje me nenin 55 të ligjit për prokurimin publik mes kriterit të përcaktimit të ofertës fituese: cmimi më i ulët ose oferta ekonomike më e favorshme. Diskrecioni i lënë nga ligjvënësi ( mes përzgjedhjes së kriterit të përcaktimit të ofertës fituese) i nënshtrohet parimit të ligjshmërisë, në zbatim edhe të nenit 11 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave

Administrative të Republikës së Shqipërisë. Konkretisht, diskrecioni për të përcaktuar kriteret e përzgjedhjes në rast të aplikimit të ofertës ekonomike më të favorshme si kriter i përcaktimit të ofertës fituese, është kufizuar nga ligjvënësi në mënyrë eksplicite, në nenin 55 të ligjit për prokurimin publik, ku *inter alia* shprehet se *oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kritere të ndryshme të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet, si: cilësia, çmimi, cilësitë teknike, karakteristikat estetike, funksionale, mjedisore, kostot e funksionimit, efektshmëria ekonomike, shërbimi pas shitjes dhe asistenca teknike, data dhe periudha e lëvrimit ose periudha e ekzekutimit, me kusht që këto kritere të jenë objektive dhe jodiskriminuese.*” Gjithashtu, edhe në nenin 31 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, është përcaktuar se “*Kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme do të përdoret në kontrata komplekse dhe të një natyre të veçantë që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmbajnë dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit kontraktor shpenzime të tilla, si kostot e shërbimeve pas shitjes, pjesët e këmbimit, zgjidhjet më të favorshme teknike, mbështetjen teknike në të ardhmen apo ato që ndotin më pak mjedisin.*” Sa më sipër, në respekt të nenit 55 të ligjit për prokurimin publik si edhe nenit 31 të rregullave të prokurimit publik, është në të drejtë të autoritetit kontraktor të përcaktojë kritere të përcaktimit të ofertës fituese si edhe të japë peshë specifike me një sistem të posacëm pikëzimi.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se fakti se autoriteti kontraktor ka përcaktuar si kriter të përcaktimit të ofertës fituese atë të ofertës ekonomike më të favorshme vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë duhet ti nënshtrohen një analize të thellë dhe të detajuar dy planëshe, së pari mbi vetë dokumentacionin e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimes mbi kriterin e kërkuar (eksperienca e ngjashme ose cilësia) dhe së dyti në rrafsh krahasimor edhe me dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik vlerësuar me pikët maksimale, duke bërë kështu një analizë të thellë midis ofertave dhe dokumentacionit të paraqitur, në rastet kur operatorët ekonomikë kanë ngritur pretendime. Në këtë mënyrë, do të garantohen edhe dy prej parimeve kyçe të zhvillimit të procedurave të prokurimit ajo e transparencës dhe barazisë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se (ratio legis) e përdorimit të kriterit të përcaktimit të ofertës fituese si oferta e ekonomike më e favorshme lidhet pikërisht me kompleksitetin e kontratës, ku krahas çmimit të kryerjes së shërbimit, një rol të rëndësishëm luajnë gjithashtu edhe cilësia e shërbimit, zgjidhjet teknike për të cilat autoriteti kontraktor ka përzgjedhur të peshojë me 20 % të pikëve cilësinë dhe metodologjinë e kryerjes së shërbimit.

Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ndonëse vlerësimi me pikë megjithëse bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, brenda diapazonit me pikë, të përcaktuar në dokumentat e tenderit, por nga ana tjetër ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, Komisioni, gjykon se, procesi i pikëzimit, duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili, nga ana tjetër, duhet të

jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e ligjit të prokurimit publik, është e tillë që, çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit.

Në lidhje me cilësinë, si në dokumentet e procedurës së prokurimit, ashtu edhe në ftesën për ofertë autoriteti kontraktor ka përcaktuar se vlerësimi do të kryhet mbi treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të punimeve dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në rastin konkret në vlerësimin e metodologjisë së dorëzuar do të merren në konsideratë elementët konkretë për të gjithë treguesit cilësore të punës, zbërthyer kjo në të gjitha elementet e saj. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se synimi i autoritetit kontraktor nuk lidhet me ri prodhimin e termave të referencës së kryerje së së shërbimit, por në drejtim të përmirësimit të tij, ri organizimit, sigurimit të cilësisë ose elementë të tjerë favorizues, që në thelb do të përbënin ofertën ekonomikë më të favorshme dhe do të garantonin cilësinë e kryerjes së shërbimit.

Konkretisht nga analizimi i metodologjisë së dorëzuar nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomik “Niem” shpk & “Avdolli” shpk rezulton se *prima facia* metodologjia e propozuar përmban të gjithë elementët e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se metodologjia e propozuar përmban të dhëna të detajuara teknike dhe përmirësim të ndjeshëm të termave të referencës së autoritetit kontraktor. Ndërkohë, parë në rrafsh krahasimor, metodologjia e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “Sireta 2 F” shpk, rezulton në një metodologji të përgjithshme dhe jo të detajuar. Konkretisht, parë në rrafsh krahasimor, rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Niem” shpk & “Avdoli” shpk ka detajuar në metodologjinë e tij organizimin e kantnierti, duke përcaktuar dy pika të favorshme, konkretisht për rrugën “Korcë-Ersekë” dhe Unaza Ersekë kantieri do të jetë në qytetin e Korcës, afër ish SMT. Ndërkohë nga ana e operatorit ekonomik “Sireta 2 F” shpk nuk konstatohet një organizim i detajuar i pikave të kantierit të cilat lidhen drejtpërdrejtë me menaxhimin e kontratës. Gjithashtu nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Niem” shpk & “Avdoli” shpk rezulton se është paraqitur një metodologji e plotë në lidhje me procesin e mirëmbajtjes dimërore ( pastrimin e dëborës) shoqëruar me një program të thelluar dhe me përllogaritje të detajuara të hapave të procesit.

Sa më sipër, duke marrë në konsideratë një analizë të detajuar në rrafshin krahasimor mes dy metodologjive, KPP gjykon se metodologjia e propozuar nga ana e operatorit ekonomik “Sireta 2 F” shpk parë edhe në rrafsh krahasimor me atë të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Niem” shpk & “Avdoli” shpk nuk shfaq një përmirësim të ndjeshëm të termave të referencës nga ana e autoritetit kontraktor, një analizë të detajuar të proceseve të punës, plan të detajuar të menaxhimit të kontratës apo të organizimit të kantierëve, kështu, për

rrjedhje vlerësimi i kryer nga ana e autoritetit kontraktor është në proporcion me dokumentacionin e dorëzuar.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues Sireta 2F shpk ngritur vetëm pranë KPP, se *BOE Niem & Avdoli shpk nuk kanë të rregjistruar ansjë makineri në rregjistrat tregëtar për të dhënat e subjekteve ndërkohë subjekti Sireta 2F shpk i ka të rregjistruara të gjitha makineritë të deklaruar në tender. Regjistrimi i makinerive është detyrim ligjor, KPP gjykon se ky pretendim përveçse i takon një faze më të hershme të procedurës së prokurimit, nuk ka respektuar shkallët e ankimit në përputhje me nenin 63 të LPP i cili parashikon se: *Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji*” (pika 2) *“Ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet me formularin përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete, baza ligjore dhe përshkrimi i shkeljes, pretendimi i ankuesit për vendimin përfundimtar, shkallët e ankimit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit kontraktor. Elementet e mësipërme janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Komisioni i Prokurimit Publik e shqyrton ankesën në përputhje me LPP, Kodin e Procedurave Administrative dhe rregullat e prokurimit publik. Mosndjekja e shkallëve të ankimit e bën ankesën të pavlefshme*” (pika 7). Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nuk mund të shprehet mbi pretendime të cilat nuk janë bërë paraprakisht objekt ankesë pranë autoritetit kontraktor. Objekti i ankesës së paraqitur pranë autoritetit kontraktor në respekt të shkallëve të ankimit nuk mund të shtohet në momentin e paraqitjes në KPP.*

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik nuk merret në shqyrtim nga KPP.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Sireta 2F” shpk për procedurën e prokurimit, *“E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”*, me Nr. REF-65444-07-14-2020, me objekt Loti III *“Mirëmbajtje rutinë dhe dimerore me performancë rruga Korce - Erseke + rruga unaza Erseke - Erseke + rruga*

*K/Boboshtice – Dardhë*”, me fond limit 199,551,855.00 Lekë pa tvsh zhvilluar më datë 21.09.2020, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1308 Protokoli, Datë 19.10.2020**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**